



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2019:073156

Datë: 06.02.2019

Numri i dokumentit: 00220053

PKR.nr.16/2019

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Gjilan - Departamenti për Krime të Rënda, përmes kryetarit të trupit gjykues Islam Thaçi, me zyrtaren ligjore Zahide Rexhepi, në lëndën penale kundër të pandehurit J. J. për shkak të veprave penale, mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 paragrafi 1 dhe veprës penale, vrasja nga pakujdesia nga neni 181 të KPRK-se, të cilin e ka mbrojtur ,av. Ymer Huruglica i caktuar sipas detyrës zyrtare, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, PP.I.Nr. 1/ 2019, të datës 28.01.2019, të cilën e përfaqëson prokurori i shtetit Arben Ismajli, pas mbajtjes së seancës shqyrtimit fillestar, më dt. 01.02.2019, shpalli publikisht, ndërsa më datën 05.02.2019 , hartoi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri J. J. nga babai Islam dhe nëna, e lindur, i lindur me dt. në Zhegër, me vendbanim në fshatin Selishtë, Komuna e Gjilanit, i martuar, baba i dhjetë fëmijëve, i pa punësuar, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së varfër ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

I.

Sepse me datën 01.01.2019, rreth orës 00:10 minuta, në fsh. Selishtë, komuna e Gjilanit, i pandehuri J. J. pa leje dhe pa autorizim ka mbajtur në pronësi dhe ka poseduar armë të gjuetisë dhe atë armën e markës Hungarian Sumbachine Gun, model 53 me nr. Serik 71115, të cilën armë e ka mbajtur në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët.

-Me çka ka kryer veprën penale , mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 paragrafi 1 të KPRK-së.

II.

Me datën 01.01.2019, rreth orës 00, 10 minuta, në fsh.Selishtë, Komuna e Gjilanit, i pandehuri J. J., nga pakujdesia me pushkën e gjuetisë të markës Hungarian Sumbachine Gun, model 53 me nr. Serik 71115, e ka privuar nga jeta bashkëshorten e tij, tani të ndjerën Z. J., në atë mënyrë që derisa kanë qenë duke festuar fillimin e vitit të ri 2019, duke shtënë më pushkën e gjuetisë në ajër e cila është bllokuar dhe nuk ka shkrepur, ashtu që gjatë tentimit të rregullimit të pushkës, e njëjta ka shkrepur dhe në një distancë 1-2 metra, të ndjerën e ka goditur në pjesën e epërme të shpinës, duke i shkaktuar lëndime vdekjeprurëse.

- Me çka kishte për të kryer veprën penale, vrasja nga pakujdesia nga neni 181 të KPRK-së.

Andaj gjykata duke u bazuar në dispozitat e sipër theksuar ligjore si dhe në neneve: 4,7,17,41,46,73,74,75,76,77 dhe 78 të KPRK-së, e në lidhje me nenin 365 të KPPK-së, të pandehurit , i

SHQIPTON

1. Për veprën penale dispozitivi I i aktakuzës, dënim me gjobë në shumë prej 400 (katërqind) euro, të cilën duhet ta paguaj në afat prej 3 muajve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Koha e kaluar në paraburgimi- përkatësisht arrest shtëpiak prej dt. 01. 01. 2019 e deri me 31.01.2019, iu është llogaritur në dënimin e shqiptuar me gjobë.

Nëse i pandehuri nuk mundet apo nuk dëshiron që ta paguaj dënimin me gjobë në shumën si më lartë, atëherë të njëjti gjykata dënimin me gjobë do t' ia zëvendësoj në dënimin me burg, duke llogaritur 20 euro te dënimit me gjobë për një ditë burg.

2.Për veprën penale, dispozitivi II të aktakuzës, vrasje nga pakujdesia na neni 181 të KPRK-së, të pandehurin, gjykata duke vepruar në kuptim të nenit 77 dhe 78 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të KPRK-së,e

LIRON NGA DËNIMI

Detyrohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor të arkëtoj shumën prej 20 euro, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit.

Të pandehurit i konfiskohet arma e gjuetisë e përshkruar si në dispozitivin I të aktakuzës.

A r s y e t i m

1.Rrjedha e çështjes

Prokuroria Themelore në Gjiilan, Departamenti për Krime të Rënda, pranë kësaj gjykate me datë 28. 01. 2019, ka paraqitur aktakuzën PP.I.nr 1/ 19, të datës , kundër të akuzuarit J. J., për shkak të veprave penale : mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 dhe veprës penale, vrasja nga pakujdesia nga neni 181 të KPRK-së.

Gjykata me datë 01.02.2019, ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar, ku prezantuan prokurori shtetit Arben Ismajli , i pandehuri J. J. me mbrojtësin e tij, av.Ymer Huruglica sipas detyrës zyrtare.

Pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit , i akuzuari J. J. ka deklaruar se e ka kuptuar në tërësi aktakuzën dhe veprat penale që i vihen në barrë si në dispozitivin I dhe II të aktakuzës, mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 dhe veprës penale, vrasja nga pakujdesia nga neni 181 të KPRK-se ,e ka pranuar fajësinë.

2.Vlerësimi i pranimi të fajësisë

Kryetari i trupit gjykues, ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë për veprat penale, me të cilat akuzohet, se i njëjti pranimin e fajësisë e ka bërë në mënyrë vullnetare, duke i ditur pasojat dhe bëni fitet e pranimi te fajësisë si dhe pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësin e tij, se i pandehuri nuk ka qenë i detyruar ose i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranoj fajësinë, se pranimi i fajësisë mbështet në faktet e çështjes të cilat i përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk përmban ndonjë shkelje ligjore e as gabime faktike.

3.Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në të lartcekurat, kryetari i trupit gjykues vërtetoi këtë gjendje faktike: se i pandehuri në kohën dhe vendin e përshkruar si në dispozitivin I dhe II, te aktakuzës, ka kryer veprat penale : mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK-së dhe veprën penale vrasja nga pakujdesia nga neni 181 të KPRK-së.

4.Elementet e veprave penale

Sipas nenit 374 paragrafi 1 të KPRK-së, thuhet se: Kush do që mban në në pronësi , kontrollon ose posedon armë në shkelje me ligjin e zbatueshëm lidhur me armë të tilla, dënohet me gjobë deri në shtatë mijë e pesëqind (7.500) euro, ose me burgim deri në pesë (5) vjet.

Sipas nenit 181 të KPRK-së, kush do që privon nga jeta personin tjetër nga pakujdesia, dënohet me burgim prej(6) muaj deri pesë (5) vjet.

Gjykata, pas dëgjimit të deklaratave të palëve lidhur me dënimin, konstatoi se te i pandehuri J.J., ekzistojnë të gjitha tiparet e veprave penale të përshkruara si në dispozitën I dhe II të aktakuzës me numer si më lartë, për çka edhe i njëjti është penalisht përgjegjës dhe fajtor, andaj, për veprën penale, dispozitivi I e shpalli fajtor dhe i shqiptoi dënimin me gjobë si ne dispozitivin e aktgjykimit, ndërsa për veprën penale, dispozitivi II i aktakuzës, vrasje nga pakujdesia, nga neni 181 të KPRK-së, të njëjtin po ashtu e shpalli fajtor dhe duke vepruar në kuptim të nenit 77 paragrafi 1 si dhe neni 78 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 të KPRK-së, **e liroi nga dënimi.**

5.Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjykata, me rastin e shqiptimit të dënimit, për të pandehurin ka pasur parasysh rrethanat lehtësuese : se i pandehuri është penduar thellë për kryerjen e veprave penale, se i njëjti i ka premtuar gjykatës se në të ardhmen do të jetë më i kujdesshëm, se nuk do të përsëris vepra të këtilla penale, se është baba i dhjetë fëmijëve i papunësuar, i gjendjes se varfër ekomomike, se i njëjti ka deklaruar se vepra penale e vrasjes nga pakujdesia e ka goditur rëndë të pandehurin, pasi që ai e ka privuar bashkëshorten e tij, e që në mënyrë shprehi more i ka deklaruar gjykatës se për mua nuk ka dënim me të madh, se sa që e kam privuar nga jeta bashkëshorten time.

Andaj gjykata erdhi në përfundim se të pandehurin vepra penale e vrasjes nga pakujdesia, përkatësisht privimi nga jeta e bashkëshortes Z. J., të pandehurin, fëmijët e tyre si dhe anëtarët tjerë të familjes, i ka goditur aq rëndë, sa që në rastin konkret , dënimi për të pandehurin do të jetë i panevojshëm për realizimin e qëllimit të tij, prandaj nga arsyet si më lartë, **e ka liruar nga dënimi .**

Ndërsa si rrethanë rënduese për të pandehurin gjykata pati parasysh shkallën e përgjegjësisë penale dhe rrezikshmërinë shoqërore të veprave penale.

Gjykata duke vepruar në pajtim me nenin 83 të KPRK-së, të pandehurit i ka llogaritur edhe kohën e kaluar në paraburgim – arrest shtëpiak, prej datës 01.01.2019 e deri më 31.01.2019.

Gjykata ka vlerësuar se ky dënimi i shqiptuar si më lartë për të pandehurin është i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale. Me rastin e matjes së dënimit të pandehurit, gjykata ka marrë për bazë të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, të parashikuara në nenin 73 dhe 76 të KPRK-së,

5.Shqiptimi i dënimit në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit dhe qëllimi i dënimit të shqiptuar

Sipas bindjes së kryetarit të trupit gjykues dënimi i shqiptuar ndaj të pandehurit duke i marr parasysh rrethanat e lartpërmendura është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale, me mënyrën e kryerjes së veprës penale si dhe shkallën e përgjegjësisë të pandehurit.

Kryetari i trupit gjykues po ashtu ka konstatuar se me këtë dënim mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit nga neni 41 të KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tij, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehja e gjykimit shoqëror për veprat penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

6.Vendimi mbi shqipitimin e dënimit plotësues

Kryetari i trupit gjykues duke u bazuar në nenin 69 paragrafi 1 dhe 2 e në lidhje me nenin 62 paragrafi 1 dhe 2, nën paragrafi 2,6 si dhe nenit 374 paragrafi 3 të KPRK-ës, të pandehurit të lartcekur i ka shqiptuar edhe **dënimin plotësues-konfiskimin e armës së gjuetisë e markës Hungarian Sumbachine Gun, model 53 me nr. Serik 71115, e sekuestruara nga ana organit kompetent.**

7.Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Duke pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të pandehurit kryetari i trupit gjykues duke u bazuar në nenin 451 paragrafi 1, e në lidhje me nenin 450 par. 1 dhe 2 nën par.2.6 të KPP-ës, ka vendosur që të pandehurin ta detyrojë t'i paguajë paushallin gjyqësor në shumën prej 20 € (njëzetë) Euro, në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Andaj duke u bazuar në të lartcekura gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**Gjykata Themelore në Gjilan - Departamenti për Krime të Rënda
PKR.nr.16/ 2019, me 05.02.2019**

**Zyrtare ligjore,
Zahide Rexhepi, d.v.**

**Kryetari i trupit gjykues
Islam Thaçi, d.v.**

Këshilla Juridike: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.

Numri i lëndës: 2019:073156
Datë: 06.02.2019
Numri i dokumentit: 00220053